

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 87, datë 29.04.2026

**PËR
REGJISTRIMIN E “BANKA OTP ALBANIA” SH.A., PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË AGJENTIT TË SHITJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË TË
FONDEVE SIKTT TË NJOHURA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 101 dhe 102 të ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe të rregullores nr. 38, datë 31.03.2023 “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Regjistrimin e “Banka OTP Albania” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shitjes në Republikën e Shqipërisë të fondeve SIKTT të njohura: OTP Multi-Asset Conservative Fund of Funds, OTP Multi-Asset Balanced Fund of Funds, OTP Multi-Asset Dynamic Fund of Funds, OTP EUR Short Bond Fund, të licencuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë, nën administrimin e shoqërisë administruese të njohur “OTP Fund Management” Ltd.**
- 2. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI